Kronikë

# Tentoi të vriste bashkëshorten, arrestohet 68-vjeçari në Vaun e Dejës! Qëlloi me armë gjahu, e goditi me grushte dhe më pas e dëmtoi me xham

*Një 68-vjeçar është arrestuar në Vaun e Dejës pasi tentoi që të vriste me armë gjahu bashkëshorten e tij. Sipas policisë, ai ka qëlluar dy herë me çifte ndaj saj, e ka qëlluar me grushte dhe më pas me xham në qafë dhe shpatull.*

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
24 Mars, 09:35 | **Përditesimi: 24 Mars, 11:43**

Share

Një 68-vjeçar në Vaun e Dejës është arrestuar pasi tentoi që të vriste bashkëshorten e tij. Sipas policisë, dyshohet se Xhabir Hoxhaj për motive xhelozie ka qëlluar dy herë me çifte ndaj bashkëshortes për ta vrarë, e ka goditur me grushte në fytyrë dhe më pas e ka dëmtuar me xham në qafë dhe shpatull.

61-vjeçarja është dërguar në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ndaj autorit rëndon akuza për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" e mbetur në tentativë. Ndërkohë, është sekuestruar arma e gjahut, dy gëzhoja dhe 17 fishekë armë gjahu.

> *"Vau i Dejës/Qëlloi me armë gjahu çifte drejt bashkëshortes, me qëllim vrasjen e saj, kapet dhe vihet në pranga 68-vjeçari.*

*LEXO EDHE:*
***Doshi i përgjigjet Berishës: Je një hajdut që vetëm shpif, më 12 maj do të kesh humbjen më të turpshme! PD-së i marrim 1 mandat në Kukës***

*Policia sekuestroi në cilësinë e provës materiale armën e gjahut çifte.*

*Shërbimet e Komisariatit të Policisë Vau i Dejës pas njoftimit të marrë se një shtetase nga Vau i Dejës po transportohej për ndihmë mjekësore drejt spitalit të Shkodrës pasi dyshohej se ishte dhunuar nga bashkëshorti, menjëherë kanë organizuar punën për sqarimin rrethanave, kapjen dhe arrestimin autorit.*

*Në bashkëpunim me Sektorin për Krimet e Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër u bë kapja e shtetasit Xh. H., 68 vjeç, banues në fshatin Mjedë dhe arrestimi në flagrancë i tij për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" e mbetur në tentativë.*

*Nga veprimet e para hetimore dyshohet se 68-vjeçari, për motive të dobëta (xhelozie) ka qëlluar 2 herë me armë gjahu çifte në drejtim të bashkëshortes për ta vrarë dhe më pas e ka goditur me grushte në fytyrë dhe e ka dëmtuar me mjet prerës (xham) në pjesën e qafës dhe shpatullës.*

*61-vjeçarja shtetasja Gj.H, ndodhet nën kujdesin e mjekëve jashtë rrezikut për jetën.*

*Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e gjahut çifte, dy gëzhoja dhe 17 fishekë armë gjahu.*

*Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.", njofton policia.*

Xh.D/I.M/Shqiptarja.com

TAG: Xhabir Hoxhaj | vau i dejes | Shkodër

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

**Sondazhi i ditës:**
**Zgjedhjet e 11 majit, a i besoni premtimet e partive?**

24 Mars, 23:36

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

**Aksidentoi të miturin dhe u largua nga vendi i ngjarjes, vihet nën hetim 28-vjeçari në Shkodër**
22 Mars, 14:13

**Shkodër/ Çelet ekspozita me veprat e fotografëve Dedë Jakova, Gegë Marubi dhe Pjetër Rraboshta në Muzeun 'Marubi'**
Ergys Kavaja
21 Mars, 17:35

**Lëvizte me armë zjarri në makinë, arrestohet 20-vjeçari në Shkodër (VIDEO)**
21 Mars, 09:08

**Kandidate në listën e mbyllur të PS në Shkodër, neomalsorja bëhë kërkesën e veçantë: 2 vajza duhet të më zëvendësojnë në punët e bujtinës**
20 Mars, 18:08

**Aksidenti në Shkodër-Velipojë/ Report TV siguron pamjet e rënda kur 25-vjeçari me motor përplaset me makinën**
20 Mars, 15:04

**Zgjedhjet/ Amuli për Report Tv: Berisha e shiti listën e kandidatëve në Shkodër, Primaret të turpshme, u tall me demokratët! PD-në e përdor për interesa personale**
20 Mars, 14:16

**I akuzuar për vrasjen e Fatbardh Licit në 2018, Apeli i GJKKO lë në burg Safet Bajrin! I 'fortë' i Shkodrës: Përgjime pa lidhje, até ditë isha në diskotekë dhe restorant peshku**
20 Mars, 12:52

**Tom Doshi i përgjigjet Berishës: Më 11 maj ndahet burri nga gënjeshtari**
19 Mars, 20:16

**Shkodër/ Xhamia e Plumbit i kthehet besimtarëve në maj, ministri Gonxhja: I rikthejmë vlerat historike dhe arkitekturore**
19 Mars, 15:28

**Rama ndan historinë e emigrantit të kthyer nga Londra në vendlindje: U riktheva në Shkodër për të hapur një Akademi Futbolli të certifikuar nga UEFA**
19 Mars, 15:09

**Ishte në kërkim ndërkombëtar për grabitje, arrestohet në Muriqan 51-vjeçari nga Maqedonia e Veriut**
19 Mars, 10:21

**'Kujt ia kanë paguar 700 mijë euro kandidatët e tu në listën e mbyllur'/ Kandidati i Bashës i përgjigjet Berishës: Pse nuk i pyete shkodranët për bashkinë që ia shite Benet Becit?**
18 Mars, 23:12



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje